



Pranuar / Dorezuar Prijmjenj/Prodato Received/Delivery	18 . 10 2023	3	viti god Year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtepi a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	65.96	2023	1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1241/2022

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.96/2021, të datës 19.12.2022, i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit AA. nr.96/2023 të datës 30.08.2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.330/2020 të datës 27.10.2020, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit: Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nen paragrafin 1.1; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.10.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.330/2020, e datës 27.10.2020, e parashtruar nga ankuesi në atë mënyrë që aprovohet pretendimi ankimor lidhur me shtesën mbi pagën bazë për kushte specifike, ndërsa, refuzohet pretendimi ankimor lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të shtesës për kushte specifike të punës dhe harmonizimin e koeficientit të pagës.

**II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Tregtisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen për kompensim të pagesës për kushte specifike.

**III. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 23.10.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mosveprimit/zbatimit të Vendimit nr.5580 të datës 04.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës, si dhe mos veprim në realizimin e së drejtës për shtesat mbi pagën bazë sipas Ligjit Nr.04/L-186 për Inspektorin dhe Mbiqëqyrjen e Tregut, dhe atë në mënyrë retroaktive nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës A.nr.330/2020, të datës 23.10.2020, me Vendimin A.nr.330/2020, të datës 09.12.2020, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit duke aprovuar si të bazuar pretendimin lidhur me pagesën mbi pagën bazë për kushte specifike, ndërsa kishte refuzuar pretendimin lidhur me kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës në mënyrë retroaktive dhe harmonizimin e koeficientit të pagës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin A.nr.330/2020, të datës 09.12.2020, ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa, kjo e fundit, me Aktgjykimin A.nr.95/2021 të datës 19.12.2022, ka anuluar Vendimin e Këshillit A.nr.330/2020 të datës 09.12.2020, duke e thyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i paknaqur me Aktgjykimin A.nr.95/2021 të datës 19.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, me datë 04.01.2023 ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin AA.nr.96/20236, ka refuzuar ankesën e Këshillit si të pabazuar, ndërsa, vërtetohet Aktgjykimi A.nr.95/2021, i datës 19.12.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative.

**Kolegji i Këshillit ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2284/2020 të datës 27.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.96/2022 të datës 30.08.2023; Ankesën e Këshillit të datës 04.01.2023 për Gjykatën e Apelit të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.95/2021 të datës 19.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; E-maili i datës 24.12.2020 nga Menaxherja e Personelit në MINT; Fletëkthesë e datës 16.12.2020; Fletëkthesë e datës 15.12.2020; Fletëkthesë e datës 15.12.2020; Fletëkthesë e datës 03.11.2020; Vendim i KPMSHCK A.nr.330/202 i datës 09.12.2020; Kërkesën e datës me Nr.4867 e datës 13.08.2020 për unifikim të koeficienteve për pozitën Inspektor i Tregut dhe kompensim të pagës sipas vlerës së ndryshimit të koeficientit e parashtruar nga inspektorët e tregut; Vendimi me numër protokolli 5880 i datës 04.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm në MINT; Vendimi me Nr.ref.02/296 i datës 03.11.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm i MINT; Vendimi me Nr.02 Ref.382 i datës 26.12.2013 për pezullim të dakorduar i marrëdhënies së punës; Kërkesën e datës 19.12.2013 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës; Vendim me numër ref. 404 i datës 19.12.2016; Akt Emërimi i datës 30.01.2012 për Përshkrimi i detyrave të punës i datës 31.07.2012 lidhur me pozitën e punës Inspektor për sigurinë e paisjeve elektrike; Kontrata e marrëdhënies së punës me nr.1196/2011 e datës 01.07.2011 për Kontrata e marrëdhënies së punës me nr.1100/2010 e datës 01.07.2010 për Kërkesë e datës 04.09.2020 nga inspektorët e inspektoratit për Ministrin e Ministrinë e Industrisë, Ndërrmarësisë dhe Tregëtisë; Kërkesë e datës 03.09.2020 me nr.5865 për Ministrin, nga Inspektorët e Inspektoriatit të tregut; E-mail i datës 03.09.202 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për Drejtoreshën e Regjistrimit të Bizneseve; E-mail i datës 14.05.2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregëtisë për Menaxheren e Personelit; E-mail i datës 07.05.2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për zv.e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë; E-mail i datës 06.05.2020 nga Menaxherja e Personelit për Kryeinspektorin e inspektoratit të Tregut; E-mail i datës 03.09.2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për Drejtoreshën e Regjistrimit të Bizneseve; Kërkesë e datës 05.05.2020 nga Inspektorët e Inspektoratit të tregut për U.d Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë; Listat e pagave për muajin shtator 2020; Aktvendim Cp.nr.2697/19 me numër 1219 i datës 21.02.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil; Aktvendim Cp.nr.476/20 me numër 5700 i datës 01.09.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil; Aktvendim Cp.nr.474/20 me numër 5699 i datës 01.09.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni

Civil; Raporti i Auditimit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 31.12.2018 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 06.11.2020.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të Aktgjykimit A.nr. 96/2023 të datës 19.12.2023, të Gjykatws Themelore nw Prishtinw, i plotfuqishwm me aktgjykimin AA.nr.96//2023 tw datws 30.08.2023 tw Gjykatws sw Apelit, Departamenti për Çështje Administrative dhe bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, rrjedhimisht, i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 30.01.2012 ushtron pozitën e punës "Inspektor për sigurinë e paisjeve elektrike" në Inspektoratin e Tregut.

Këshilli me Vendimin me numër A.nr.330/2020 të datës 27.10.2020, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, duke vlerësuar se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhej vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për Administratë Publike, siç parashihej me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i aplikueshëm në kohën e shqyrtimit të ankesës A.nr. 330/2020 të datës 23.10.2020 përkatësisht nënin 16 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *...institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civil, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni*, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nënin 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *"...për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.*

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar, se organi i punësimit në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.330/2020 të datës 23.10.2020, përmes shkresës me numër protokollit 3294/2020 të datës 24.12.2020 ka njoftuar Këshillin së me datë 18.12.2020 kanë parashtruar kërkesë të Ministria e Punëve të Brendshme si Ministri përgjegjëse për Administratë Publike për miratimin e shtesës për kushte tregu si dhe caktimin e shumës së shtesës, mirëpo që nga provat e lëndës nuk vërtetohet së kjo kërkesë është miratuar nga organi kompetent.

Andaj, duke qenë se në riprocedurë kemi rrethana të reja ligjore, përkatësisht kemi ndryshime ligjore përkitazi me sistemin e pagave dhe shtesave të nëpunësve civil, Kolegji lidhur me pretendimin ankimor për shtesa të veçanta mori parasysh dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i aplikueshëm nga data 05.02.2023, ku i njëjti me dispozitat e nënit 45 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe çdo dispozitë të ligjit apo të aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.

Ne kontekst të kësaj, Kolegji ju referua nënin 26 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me të cilin është përcaktuar se: *Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja sipas nënit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj*

pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për finance”, si dhe Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, ku me dispozitat e nenit 7, është paraparë se: 1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me të dhënat si në vijim: 1.1. pozitën dhe numrin e të punësuarve në këtë pozitë; 1.2. përshkrimin e punës të të punësuarit; 1.3. arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; 1.4. klasën dhe koeficientin. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, në këtë përbërje: 2.1. përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit; 2.2. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për financa; 2.3. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.... 5. Komisioni është përgjegjës të përpiloj raport përfundimtar në bazë të kërkesave të institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili duhet të përmbaj: 4.1. lista me pozitat për të cilat kërkohet shtesa e kushteve specifike të punës, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin përkatës për pagat dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje; 4.2. vlerën indikative të rekomanduar për secilën kategori potencialisht përfituese të shtesës për kushte specifike të punës, duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 4.3. shkaqet për mos përfshirjen e kërkesave të tjera të pranuar në përfitimin e shtesës; dhe 4.4. informatat tjera që konsiderohen relevante nga Komisioni. 5. Me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. 6. Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për Financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar. 7. Komisioni, në çdo kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovuar në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj.

Andaj, Kolegji pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit si më lartë, vlerëson se Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për trajtimin e çështjes që është objekt i kësaj ankese, rrjedhimisht, në pajtim me dispozitat e nenit 26 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, të parashtrorj kërkesë për miratimin e shtesave për kushte specifike të komisioni kompetent.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data kur ligji ka hy në fuqi Ligjit Nr.04/L-186 për Inspektorin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Kolegji ka konstatuar se ky ligj është publikuar në Gazetën zyrtare me datë 10.05.2013, ndërsa ankuesi nga data e hyrjes në fuqi të ligjit me datë 25.05.2023 e deri me datë 23.10.2020 (data e parashtrimit të ankesës në Këshill) nuk kishte ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të realizimit të kësaj të drejte, andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pabazuar për faktin se ankesa është e parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ..*

Ndërsa, referuar pretendimit ankimor të ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës, sipas Vendimit nr.5880 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji gjatë rishqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në pozitën “Inspektor për sigurinë e pajisjeve elektrik” me koeficient të pagës shtatë (7), duke nënshkruar pa asnjë vërejtje Akt Emërimin e datës 30.01.2012, ndërsa, Sekretari i Përgjithshëm i MINT, përmes Vendimit nr.5880 të datës 04.09.2020 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), mirëpo, me datë 03.11.2020 me Vendimin me numër 8251, ka pezulluar zbatimin e Vendimit nr.5871 me arsyetimin se Ministria e Tregtisë

dhe Industrisë nuk ka buxhet për harmonizimin e koeficientit të pagës. Ndërlidhur me këtë pretendim, Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar së sipas Autorizimit të datës 04.06.2018 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil lidhur me shpalljen e pozitave inspektor i tregut ishte vendosur koeficient shtatë (7) i pagës, andaj, mbi bazën e këtyre fakteve rrjedh së pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pa qëndrueshëm.

Theksuar si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1241/2022

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë,
- Arkivit të KPMSHCK-së

